



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 200/10 prot.

Tiranë, më 26.01.2022

VENDIM

Nr. 10 , datë 26.01.2022

PËR

**“MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË MËSIMORE, PËR FAKULTETIN E
MJEKËSISË DENTARE, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”**

Në bazë të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Statutit të UMT-së, VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor” të Ministrit të MFE-së dhe Ministrit të MASR-së, Vendimit të Bordit të Administrimit nr.33 datë 26.04.2021 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2021, në UMT”, pika 2 e tij, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim materialin e Administratorit të UMT-së nr.3272/2 prot., datë 24.12.2021 “Kërkesë për miratimin e pagesës së qirasë mësimore të Fakultetit të Mjekësisë Dentare”,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e qirasë mësimore për vitin akademik 2019-2020, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në vlerën 364,059 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e nëntë) lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ